



EHEAROME2020

---

# Komunikata Ministore Romë

---

19 NËNTOR 2020



EUROPEAN  
Higher Education Area



bologna  
process



ITALIAN **BFUG** SECRETARIAT  
2018-2020



Translated within the Erasmus+ project “[IN-GLOBAL Enhancing Knowledge of the EHEA and Global Dialogue](#)” in 2023.

The original version of the Rome Communiqué and its annexes are available on the website of the European Higher Education Area:

<https://ehea.info/page-ministerial-conference-rome-2020>



**Co-funded by  
the European Union**

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or the European Education and Culture Executive Agency (EACEA). Neither the European Union nor EACEA can be held responsible for them.





Ne, ministrat përgjegjës për arsimin e lartë, në takimin online më 19 nëntor 2020, festojmë arritjet e 21 viteve nga nënshkrimi i Deklaratës së Bolonjës. Ne rikonfirmojmë angazhimin tonë për të zhvilluar një Zonë Evropiane të Arsimit të Lartë (ZEAL) më gjithëpërfshirëse, inovative, të ndërlidhur dhe të qëndrueshme.

Ne falenderojmë Italinë për rolin e saj kyç në përgatitjen dhe organizimin e konferencës sonë dhe për përshtatjen e saj me sfidat e pandemisë COVID-19.

ZEAL është bashkëpunim unik me në qendër besimin, ku autoritetet publike dhe aktorët e arsimit të lartë punojnë së bashku për të përcaktuar dhe për të arritur qëllime të përbashkëta. Falë larmisë së kulturave, gjuhëve dhe mjediseve tona, dhe angazhimit tonë të përbashkët për cilësinë, transparencën dhe mobilitetin, sistemet tona të arsimit të lartë ofrojnë mundësi të pakrahasueshme për mësim, mësimdhënie, kërkim dhe inovacion.

Shoqëritë tona po përballen me sfida të pashembullta që lidhen me përhapjen mbarëbotërore të COVID-19 dhe pasojat e tij. Pandemia tregoi se sa të ndërvarur jemi dhe sa të brishtë mund të jemi. Pandemia e bëri të dukshme që të gjithë i përkasim të njëjtës botë, ku solidariteti njerëzor është thelbësor. Ne i dallojmë dhe i vlerësojmë shumë përpjekjet e komunitetit të arsimit të lartë për t'iu përgjigjur këtyre sfidave dhe e ripohojmë vendosmërinë tonë për të ofruar arsim të lartë cilësor gjithëpërfshirës që përmbush sferën e plotë të qëllimeve edhe në kohë krize.

Ne jemi të vendosur t'u mundësojmë institucioneve tona të arsimit të lartë angazhimin me shoqëritë tona për të adresuar kërcënimet e shumta ndaj paqes globale, vlerave demokratike, lirisë së informacionit, shëndetit dhe mirëqenies — sidomos kërcënimet e krijuara ose të përkeqësuar nga pandemia. Ne zotohemi të vazhdojmë dhe të rrisim investimin tonë në arsim, për të siguruar që institucionet e arsimit të lartë të kenë fondet e duhura për të gjetur zgjidhje për krizën aktuale, rimëkëmbjen pas krizës, dhe në përgjithësi, tranzicionin drejt ekonomive dhe shoqërive të gjelbra, dhe të qëndrueshme.

Ne jemi të përkushtuar të kapërcejmë pabarazitë sociale që ende kufizojnë arritjen e një ZEAL-i tërësisht gjithëpërfshirëse. Dixhitalizimi ka mundësuar që shumica e sistemeve tona të vazhdojnë të funksionojnë gjatë pandemisë COVID-19, edhe pse përdorimi i shtuar i mjeteve dixhitale ka nxjerrë në dritë disa kufizime. Arsimi i lartë duhet të marrë një rol kryesues në eksplorimin dhe këshillimin e adresimit dhe kapërcimit të këtyre kufizimeve, prej përvojës së konsoliduar të bashkëpunimit dhe hulumtimit transkombëtar dhe ndërkombëtar.

Ne shikojmë me vendosmëri dhe optimizëm drejt vitit 2030, me besim se do të kemi sukses në nxitjen e bashkëpunimit më efektiv dhe dialogut më të ngushtë ndërmjet vendeve tona, sistemeve dhe institucioneve tona të arsimit të lartë dhe me komunitetin më të gjerë të arsimit të lartë.

Kemi kënaqësinë të mirëpresim San Marinon si Anëtar të ri i ZEAL. San Marino do të mbështetet në zbatimin e angazhimeve të saj nëpërmjet një udhërrëfyesi të dakordësuar.

## Vizioni Ynë

Ne e përfytyrojmë ZEAL-in si një zonë ku studentët, stafi dhe të diplomuarit mund **të lëvizin lirisht** për studim, mësimdhënie, dhe kërkim shkencor. **ZEAL-i i vizionit tonë do të respektojë plotësisht vlerat themelore të arsimit të lartë si dhe demokracinë dhe sundimin e ligjit.** Kjo zonë do të nxisë kreativitetin, mendimin kritik, qarkullimin e lirë të njohurive dhe do të zgjerojë mundësitë që ofron zhvillimi teknologjik për nxënien dhe mësimdhënien e bazuar në kërkim shkencor. Do të sigurojë që sistemet tona të arsimit të lartë t'u ofrojnë të gjithë studentëve mundësi të barabarta, në përputhje me potencialin dhe aspiratat e tyre. Ne e pranojmë se realizimi i këtij vizioni kërkon miratimin e politikave dhe masave zbatuese në kornizat tona kombëtare, që disa prej syresh arrijnë përtej sistemeve tona të arsimit të lartë dhe që sjellin përafrimin me strategji më të gjera kombëtare ekonomike, financiare dhe sociale.

Për të arritur vizionin tonë deri në vitin 2030, ne angazhohemi të ndërtojmë një ZEAL gjithëpërfshirëse, inovative dhe të ndërlidhur, që të mund të mbështesë një Evropë të qëndrueshme, kohezive dhe paqësore:

- **Gjithëpërfshirëse**, sepse çdo student do të ketë qasje të barabartë në arsim të lartë dhe do të mbështetet plotësisht në përfundimin e studimeve dhe trajnimit;
- **Inovative**, sepse do të prezantojë metoda të reja dhe më të harmonizuara të të nxënies, mësimdhënies dhe vlerësimit, si dhe praktika të lidhura ngushtë me kërkimin shkencor;
- **Të ndërlidhur**, sepse kornizat dhe mjetet tona të përbashkëta do të vazhdojnë të lehtësojnë dhe të përmirësojnë bashkëpunimin dhe reformat ndërkombëtare, shkëmbimin e njohurive dhe lëvizshmërinë e stafit dhe studentëve.

Institucionet e arsimit të lartë kanë potencialin për të nxitur ndryshime të mëdha — duke përmirësuar njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e studentëve dhe shoqërisë për të kontribuar në qëndrueshmërinë, mbrojtjen e mjedisit dhe objektiva të tjera thelbësore. Ato duhet t'i përgatisin studentët që **të bëhen qytetarë aktivë, kritikë dhe të përgjegjshëm** dhe të ofrojnë mundësitë e të mësuarit gjatë gjithë jetës për t'i mbështetur në rolin e tyre shoqëror.

Arsimi i lartë do të jetë një aktor kyç **në përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (SDGs) deri në vitin 2030.** Ne angazhohemi të mbështesim institucionet tona të arsimit të lartë në ngritjen e kapaciteteve të tyre arsimore, kërkimore dhe të inovacionit, për të përballuar këto objektiva themelore globale dhe për të gjetur burime që sigurojnë se sistemet tona të arsimit të lartë të kontribuojnë në arritjen e **SDG**. Lëvizja drejt neutralitetit klimatik është thelbësore për të gjithë ne dhe studentët duhet të përgatiten për punë dhe aktivitete të reja “të gjelbra”. Atyre duhet t'u ofrohen mundësitë e ngritjes së aftësive dhe rikualifikimit në perspektivën e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të mundësuar zhvillimin dhe aplikimin e teknologjive dhe qasjeve të reja.

**Arsimi cilësor** do të vazhdojë të jetë shenja dalluese e ZEAL-it. Një kulturë e fortë **akademike dhe shkencore integriteti shkencor** që ndalon të gjitha format e mashtrimit akademik dhe shtrembërimit të së vërtetës shkencore, që do të mbështetet nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe të gjitha autoritetet publike.

## Vlerat Themelore

Ne ripohojmë angazhimin tonë për të promovuar dhe për të mbrojtur **vlerat tona themelore të përbashkëta në të gjithë ZEAL-in përmes dialogut dhe bashkëpunimit politik të intensifikuar** si bazë e nevojshme për mësimnxënie cilësore, mësimdhënie dhe kërkim si dhe për shoqëritë demokratike. Ne zotohemi të ruajmë autonominë institucionale, lirinë akademike dhe integritetin, pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit në qeverisjen e arsimit të lartë dhe përgjegjësinë publike për dhe të arsimit të lartë.

Ne i kërkojmë BFUG-së të zhvillojë **një kornizë** për rritjen e vlerave themelore të ZEAL-it që do të nxisë vetë-reflektim, dialog konstruktiv dhe të mësuarit nga kolegët në të gjithë autoritetet kombëtare, institucionet e arsimit të lartë dhe organizatat, duke bërë të mundur edhe vlerësimin e shkallës në të cilën këto vlera respektohen dhe zbatohen në sistemet tona. Ne miratojmë **përkufizimin e lirisë akademike** si liri e personelit akademik dhe studentëve që të angazhohen në hulumtim, nxënie, mësimdhënie dhe komunikim brenda dhe me shoqërinë, pa ndërhyrje dhe as frikë nga masat ndëshkuese ([Shtojca I](#)).

Ne ripohojmë angazhimin tonë për të nxitur etikën, transparencën dhe integritetin në dhe nëpërmjet edukimit dhe kërkimit dhe vëmë re se Platforma e Këshillit të Evropës për Etikën, Transparencën dhe Integritetin në Arsimit (Platform on Ethics, Transparency and Integrity in Education — ETINED) ofron mundësi për të gjithë anëtarët e ZEAL-it, anëtarët konsultativë dhe partnerët për të bashkëpunuar për të arritur këtë qëllim.

## Ndërtimi i së Ardhmes

### ZEAL gjithëpërfshirëse

**Arsimi i lartë social gjithëpërfshirës** do të mbetet në qendër të ZEAL-it dhe do të kërkojë ofrimin e mundësive dhe mbështetje për përfshirje të barabartë të individëve nga të gjitha pjesët e shoqërisë. Studentë me prejardhje të ndryshme socio-ekonomike, profesionale, kulturore dhe arsimore duhet të kenë mundësinë dhe mjetet për të kërkuar dhe për të përfituar, në çdo moment, opsionet e edukimit më të dobishme.

Ne zotohemi të përforcojmë përfshirjen sociale dhe rritjen e edukimit cilësor, duke përdorur plotësisht mundësitë e reja që ofrohen prej dixhitalizimit. Ndërkohë që shoqëritë tona mbështeten gjithnjë e më shumë në teknologjitë inovative, përfshirë ato të inteligjencës artificiale, ne duhet të sigurohemi që këto të respektojnë standardet etike dhe të drejtat e njeriut dhe të nxisin gjithëpërfshirjen. Ne pranojmë se dixhitalizimi nuk ofron zgjidhje “një masë për të gjithë” dhe kërkojmë nga BFUG-ja të propozojë mënyra si mund të përfitojnë të gjithë studentët nga teknologjitë e reja.

Ne miratojmë **“Parimet dhe Udhëzimet për Forcimin e Dimensionit Social të Arsimit të Lartë në ZEAL”** ([Shtojca II](#)) bazuar në një kuptim të zgjeruar të dimensionit social dhe zotohemi t’i zbatojmë në sistemet tona. Ne do të angazhohemi në një dialog të gjerë politikash që këto parime dhe udhëzime të zbatohen plotësisht në nivel kombëtar. Ne do të mbështesim institucionet tona të arsimit të lartë në integrimin e tyre në kulturën dhe misionet e tyre kryesore institucionale: mësimi dhe mësimdhënia, hulumtimi dhe inovacioni, qarkullimi dhe shpërndarja e njohurive, qeverisja dhe menaxhimi institucional. Kërkojmë nga BFUG-ja të na raportojë në vitin 2024 mbi hapat e ndërmarrë dhe masat përkatëse të monitorimit për të siguruar monitorimin e bazuar në prova.

Ne e njohim rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të studentëve nëpërmjet legjisllacionit; ne zotohemi t’i zhvillojmë dhe t’i mbështesim brenda sistemeve tona kombëtare nëpërmjet masave dhe strukturave të dedikuara, si p.sh. avokatët e popullit të studentëve ose zgjidhje të ngjashme që ekzistojnë tashmë në shumë vende të ZEAL-it. Ne zotohemi të mundësojmë marrëveshje të tilla brenda vendeve dhe sistemeve tona të arsimit të lartë dhe të inkurajojmë bashkëpunimin brenda Rrjetit Evropian të Avokatëve të Popullit në Arsimin e Lartë (European Network of Ombuds in Higher Education — ENOHE).

## ZEAL inovative

Ne mbështesim institucionet tona të arsimit të lartë në intensifikimin e hulumtimit për **zgjdhjen e sfidave me të cilat përballen shoqëritë tona. Shkencat dhe artet sociale, humane dhe krijuese** duhet të vazhdojnë të luajnë rolin e tyre jetik, duke i dhënë thellësi jetës sonë dhe duke na mundësuar të kuptojmë dhe të veprojme në një botë përherë në ndryshim. Institucionet tona të arsimit të lartë duhet të angazhohen me komunitetet e tyre për të ndërmarrë aktivitete të përbashkëta të dobishme dhe të përgjegjshme shoqërore.

**Përditësimi i shpejtë i njohurive, aftësive dhe kompetencave** do të jetë i domosdoshëm për t'iu përgjigjur sfidave dhe për të zhvilluar mundësitë që do të sjellë dekada e re. Institucionet e arsimit të lartë do të vazhdojnë të diversifikojnë ofertën e të mësuarit dhe të sjellin risi në përmbajtje dhe mënyra të ofrimit, që t'i përgjigjen nevojave në rritje për mendim inovativ dhe kritik, inteligjencë emocionale, lidhshmëri, punë në grup dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve, si dhe qëndrime sipërmarrëse.

**Mënyrat e mësimit fleksibël dhe të hapura**, pjesë e frymëzimit fillestar për Procesin e Bolonjës, janë aspekte të rëndësishme të të mësuarit me **në qendër studentin** dhe janë kërkesë në rritje në shoqëritë tona. Përveç programeve të plota, shumë institucione të arsimit të lartë ofrojnë ose planifikojnë të ofrojnë njësi më të vogla të të mësuarit, të cilat u mundësojnë studentëve të zhvillojnë ose të përditësojnë aftësitë dhe kompetencat e tyre kulturore, profesionale dhe transversale në faza të ndryshme të jetës së tyre. Ne i kërkojmë BFUG-së të eksplorojë, se si dhe në çfarë mase, këto **njësi më të vogla, fleksibël, duke përfshirë ato që çojnë në mikro-kredenciale**, mund të përcaktohen, zhvillohen, zbatohen dhe njihen nga institucionet tona duke përdorur mjetet e ZEAL-it.

Ne miratojmë **"Rekomandime për Autoritetet Kombëtare mbi Përmirësimin e Mësimit të Arsimit të Lartë dhe Mësimdhënia në ZEAL" (Shtojca III)** dhe zotohemi t'i ndjekim, duke mbështetur institucionet e arsimit të lartë në zbatimin e mëtejshëm të të nxënies dhe mësimdhënies me në qendër studentin. Rekomandimet përfshijnë mbështetje të shtuar për të gjithë studentët dhe për stafin mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës. Stafi akademik, duke përfshirë akademikët e rinj, kërkojnë mundësi punësimi dhe karriere stabël/fikse, barazi të vlerësimit për mësimdhënien dhe hulumtimin, kushte pune tërheqëse, qasje në zhvillimin e përditësuar të stafit dhe njohje të arritjeve të tyre. Në të gjitha këto aspekte, ne do të nxisim dialogun dhe bashkëpunimin për nxënien dhe mësimdhënien në sistemet tona kombëtare dhe në nivel të ZEAL-it.

Ne zotohemi të mbështesim institucionet tona të arsimit të lartë në përdorimin e teknologjive dixhitale për nxënie, mësimdhënie dhe vlerësim, si dhe për komunikimin dhe hulumtimin akademik, dhe për të investuar në **zhvillimin e aftësive dhe kompetencave dixhitale për të gjithë**. Ne zotohemi të zhvillojmë shkencën dhe arsimin e hapur, për të lehtësuar shkëmbimin e njohurive dhe **materialeve të licencuara dhe të hapura** që mund të ndahen lehtësisht mes arsimit të lartë dhe palëve të interesuara, të cilët mund t'i përshtatin dhe t'i përdorin për nevojat e tyre.

## ZEAL e ndërlidhur

**Bashkëpunimi dhe mobiliteti** lidhin sistemet tona dhe nxisin zhvillimin e kompetencave ndërkulturore dhe gjuhësore, njohurive dhe kuptimit më të gjerë të botës sonë. Kontaktet dhe sinergjitë e drejtpërdrejta ndërmjet kulturave të ndryshme dhe sistemeve të arsimit të lartë, nëpërmjet lëvizshmërisë së stafit dhe studentëve, kontribuojnë në përsosmërinë dhe rëndësinë e arsimit të lartë në ZEAL, duke e bërë tërheqës dhe konkurrues në shkallë globale. Ne e njohim rëndësinë dhe përfitimet e lëvizshmërisë fizike për studentët, kandidatët për doktoraturë dhe stafin.

Pavarësisht vështirësive aktuale që lidhen me pandeminë COVID-19, ne ripohojmë objektivin tonë që të paktën **20% e të diplomuarve në ZEAL** të kenë mundësinë të përjetojnë një periudhë studimi ose trajnimi jashtë vendit dhe të angazhohen **më tej për t'u mundësuar të gjithë studentëve që të fitojnë kompetenca ndërkombëtare dhe ndërkulturore përmes ndërkombëtarizimit të kurrikulave** ose pjesëmarrjes në mjedise inovative ndërkombëtare në institucionet e tyre të origjinës, dhe **të përjetojnë një formë të lëvizshmërisë**, qoftë në formate fizike, dixhitale (virtuale) ose të përziera.

Zgjidhjet dixhitale do të lehtësojnë **shkëmbimin** e sigurt, efikas dhe transparent të **të dhënave**. Për të përmirësuar qasje të përbashkëta dixhitale nevojitet njohja, sigurimi i cilësisë dhe lëvizshmëria. Ne i kërkojmë BFUG-së të hartojë zgjidhjet ekzistuese dhe të gjejë të tilla të reja për të përmirësuar ndërveprimin e sistemeve dixhitale dhe shkëmbimin e të dhënave studentore dhe institucionale duke respektuar tërësisht privatësinë dhe sigurinë, duke marrë parasysh përvojat e Iniciativës Evropiane të Kartës Studentore dhe nismave të tjera.

Bashkëpunimi më i ngushtë ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë do të ndihmojë në adresimin e objektivave të mësipërm në mësimdhënie dhe kërkime të përbashkëta. Ne do të përpiqemi të eliminojmë pengesat për bashkëpunimin në nivel kombëtar dhe t'i mundësojmë të gjithëve institucioneve të arsimit të lartë në ZEAL të përfitojnë prej tij. Aleancat e krijuara nën Iniciativën e Universiteteve Evropiane janë një mënyrë e rëndësishme për të eksploruar bashkëpunimin sistematik më thellë e më gjerë, gjë që mund të jetë e dobishme për tejkalimin e pengesave për bashkëpunim më të ngushtë ndërkombëtar nga institucionet e arsimit të lartë në të ardhmen.



## Zbatimi

Ne marrim parasysh rezultatet e përshkuara në **Raportin e Zbatimit të Procesit të Bolonjës** mbi progresin e bërë gjatë dy dekadave të fundit. Arritjet janë mbresëlënëse. Megjithatë, kërkohet më shumë punë për të siguruar që ZEAL-i i ka bazat e forta, të afta për të mbështetur arsimin e lartë të ndërlidhur, inovativ dhe gjithëpërfshirës në dekadën e ardhshme.

Ne mbështetemi në përkrahjen e vazhdueshme të programit Erasmus dhe programeve të tjera të mobilitetit dhe bashkëpunimit për të çuar përpara angazhimet tona.

Në Konferencën Ministrore të Parisit në 2018, ne vendosëm t'i kushtojmë përpjekje të veçanta përfundimit të zbatimit të tre **"Angazhimeve kryesore"** thelbësore për funksionimin e ZEAL-it: Kornizat e Kualifikimeve dhe ECTS, Konventa e Lisbonës për Njohjen e Kualifikimeve dhe Suplementin e Diplomës, dhe Sigurimi i Cilësisë sipas Standardeve dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG).

Ne ripohojmë vendosmërinë tonë për zbatimin e plotë të zotimeve kryesore. Ne i kërkojmë BFUG-së të vazhdojë të përdorë **metodën e mbështetjes së kolegëve** për ta arritur këtë. Ne angazhohemi të marrim pjesë dhe të kontribuojmë në mënyrë të vazhdueshme në këtë përpjekjeje.

Ne zotohemi të plotësojmë dhe të zhvillojmë më tej **Kornizat Kombëtare të Kualifikimeve** në përputhje me **Kuadrin Gjithëpërfshirës të Kualifikimeve të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (QF-EHEA)** dhe i kërkojmë BFUG-se të përditësojë kriteret për vetë-certifikim, duke përfshirë një element më të fortë të rishikimit nga kolegët në raportet kombëtare. Ne mandatojmë **Rrjetin e Korrespondentëve të Kornizave të Kualifikimeve** që të vazhdojë punën, duke kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të QF-EHEA dhe vetë-certifikimin e kornizave kombëtare të kualifikimeve ndaj tij.

Ne do të forcojmë zbatimin e **Konventës së Lisbonës së Këshillit të Evropës/UNESCO-s** për Njohjen e Kualifikimeve dhe të zbatojmë parimet e saj për kualifikimet dhe periudhat e studimit jashtë ZEAL-it, duke përdorur kriteret të përbashkëta vlerësimi dhe raportimi, në bashkëpunim me Komitetin e Konventës së Lisbonës për Njohjen e Kualifikimeve dhe Rrjetet ENIC dhe NARIC.

Ne do të sigurojmë **njohjen automatike të kualifikimeve akademike dhe periudhave të studimit brenda ZEAL-it** në mënyrë që studentët, stafi dhe të diplomuarit të jenë në gjendje të lëvizin lirshëm për të studiuar, për të dhënë mësim dhe për të bërë kërkime. Ne do të bëjmë ndryshimet legjislative e nevojshme për të garantuar njohjen automatike në nivel sistemi për kualifikimet e ofruara në vendet e ZEAL-it në të cilat sigurimi i cilësisë funksionon në përputhje me ESG dhe në të cilat është krijuar korniza e kualifikimeve kombëtare plotësisht funksionale. Ne gjithashtu inkurajojmë aplikimin e sistemeve të dakorduara dhe të sigurta të certifikimit dhe komunikimit dixhital si blockchain, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të Bazës së të Dhënave dhe Rezultateve të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë (Database of External Quality Assurance Results — DEQAR) për të lehtësuar njohjen automatike.

Ne zotohemi të rishikojmë legjislacionin, rregulloret dhe praktikën tonë për të siguruar njohje të drejtë të kualifikimeve që mbahen nga refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat në situata të ngjashme me refugjatët, edhe kur këto kualifikime nuk mund të jenë plotësisht të dokumentuara në përputhje me nenin VII të Konventës së Lisbonës për Njohjen e Kualifikimeve. Ne e mirëpresim **Pasaportën Evropiane të Kualifikimit për Refugjatët** dhe do të mbështesim zgjerimin e mëtejshëm të përdorimit të saj në sistemet tona.

Ne e njohim progresin në zhvillimin e **sistemeve të sigurimit të cilësisë** në përputhje me ESG, dhe angazhohemi të heqim pengesat e mbetura, përfshirë ato që lidhen me funksionimin ndërkufitar të agjencive të regjistruara në EQAR dhe aplikimin e Qasjes Evropiane për Sigurimin e Cilësisë së Programeve të Përbashkëta. Ne zotohemi të sigurojmë që marrëveshjet tona të jashtme të sigurimit të cilësisë të mbulojnë arsimin e lartë transkombëtar në ZEAL me standarde të barabarta, njësoj si brenda vendit. Duke pasur parasysh nevojën për rritjen e fleksibilitetit dhe hapjes së shtigjeve të nxënies, njësisive më të vogla të të mësuarit dhe sinergjive më të mëdha midis institucioneve të arsimit të lartë, ne inkurajojmë **një përdorim të ESG të orientuar drejt përmirësimit, për të mbështetur inovacionin në arsimin e lartë dhe sigurimin e cilësisë.**

Ne angazhohemi për të forcuar bashkëpunimin me **Zonën Evropiane të Kërkimit**. Ne bëjmë thirrje që BFUG të punojë ngushtë me Komitetin e Zonës Evropiane të Kërkimit dhe Inovacionit (European Research Area and Innovation Committee — ERAC) për të rritur sinergjitë dhe përafrimin ndërmjet politikave të arsimit kërkimit dhe inovacionit. Fokusi do të jetë, ndër të tjera, në zhvillimin e të mësuarit të bazuar në kërkime, garantimi i lirisë akademike dhe shkencore, dhe kontributi në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

Ne angazhohemi për **të ndërtuar një komunitet më të ndërlidhur dhe të qëndrueshëm të arsimit të lartë**, i cili nxit përfshirjen, komunikimin, bashkëpunimin dhe solidaritetin, thelbësore për **rëndësinë dhe përsosmërinë e ZEAL-it në të ardhmen**.

Për ta arritur këtë, ne zotohemi t'i mbajmë të informuar dhe të përfshirë sektorët tanë kombëtarë të arsimit të lartë me zhvillimet në ZEAL dhe të punojmë ngushtë me shoqatat dhe rrjetet e studentëve dhe të arsimit të lartë në zhvillimin dhe zbatimin e reformave kombëtare. Ne e njohim rëndësinë e konsultimeve të gjera të kryera jashtë për të identifikuar prioritetet për të ardhmen e ZEAL-së dhe për t'i kërkuar BFUG-së të organizojë evente të ZEAL, si **seminare dhe seanca dëgjimore** që përfshijnë komunitetin e gjerë të arsimit të lartë (studentët, stafin akademik dhe palët e jashtme të interesit), për të diskutuar qëllimet e tanishme dhe të ardhshme dhe për të eksploruar mënyra bashkëpunuese për t'i adresuar ato.

## ZEAL në një mjedis global

Ndërsa pandemia e COVID-19 e ka bërë të pamundur mbajtjen e Forumit të Politikave Globale sipas synimit fillestar, ne jemi të kënaqur se Konferenca jonë përfshin një sesion global. Ne angazhohemi sërish për dialogun ndërkombëtar për vlerat e arsimit të lartë, politikat dhe reformat, duke u mbështetur në përvojat e ZEAL-it si dhe ato të zonave të tjera të botës, dhe kërkojmë nga BFUG-ja të zhvillojë dhe të forcojë më tej Dialogun Global në periudhën e ardhshme të punës.

Ne mirëpresim miratimin e **Konventës Globale të UNESCO-s për Njohjen e Kualifikimeve në Arsimin e Lartë dhe zotohemi ta ratifikojmë menjëherë**, në mënyrë që të lehtësohet njohja e drejtë e kualifikimeve dhe periudhat e studimit jashtë ZEAL-it, duke përdorur kriteret e vlerësimit në përputhje me Konventën e Lisbonës për Njohjen e Kualifikimeve dhe raportimin.

Ne vlerësojmë përfshirjen e vlerave globale të diversitetit dhe përgjegjësitë sociale dhe qytetare në **Magna Charta Universitatum**, të përditësuar së fundmi.

## Konkluzione

Ne i bëjmë thirrje BFUG-së të adresojë veprimet dhe prioritetet e treguara për dekadën e ardhshme me qëllimin e përgjithshëm të krijimit të një **Zone Evropiane të Arsimit të Lartë që përmbush vizionin tonë dhe arrin objektivat tona deri në vitin 2030**.

Ne i japim mandat BFUG-së të prodhojë një raport zbatimi në Konferencën e vitin 2024 që vlerëson progresin në marrëveshjen dhe angazhimet tona.

Ne pranojmë me mirënjohje ofertën e Shqipërisë për të organizuar Konferencën e radhës Ministrore dhe Forumin e Politikës Globale të ZEAL-it në 2024.

## Shtojcat

- **Shtojca I** e Komunikatës së Ministrave në Romë: Deklarata mbi Lirinë Akademike
- **Shtojca II** e Komunikatës së Ministrave në Romë: Parimet dhe Udhëzimet për Forcimin e Dimensionit Social të Arsimit të Lartë në ZEAL
- **Shtojca III** e Komunikatës së Ministrave në Romë: Rekomandime për Autoritetet Kombëtare mbi Përmirësimin të Mësimin dhe Mësimdhënies së Arsimit të Lartë në ZEAL



Co-funded by  
the European Union

This translation is co-funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or the European Education and Culture Executive Agency (EACEA). Neither the European Union nor EACEA can be held responsible for them.



